



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POROSITES: BASHKIA SHKODER

INFORMACION I PERGJITHSHEM

OBJEKTI:

**"Rikonstruksioni i Rrugës Shkodër - Velipojë"
segmenti Harku i Berdices - Baks**

"ERALD-G" shpk



"ERALD - G" Sh.p.k

Adresa:Rr.Kongresi i Lushnjes,21 Dhjetori.Tirane
Email:eraldgshpk@yahoo.com
Cel:+355 68 20 90 392

TIRANË 2017

INFORMACION

Objekti: "Rikonstruksion i rrugës Shkodër - Velipojë"

Gjatesia totale e rruges: 18,311 km

Loti I.

Pik. 0-175, prog. 0-4260. Vlera: 1.178.019.762 leke

Loti II.

Pik. 175-430, prog. 4260-10245. Vlera: 844.089.842 leke

Loti III.

Pik. 430-774, prog. 10245-18311. Vlera 1.109.145.853 leke

Profili i rruges: 2 x 3.75m trup rruge, 2 x 1.25m bankine e paasfaltuar.

Shtresat e rruges: 4cm asfaltobeton, 6cm binder, 15cm stabilizant, 2 x 20cm zhavorr.

Pozicioni gjeografik i vendit.

Destinacioni fundor i rruges eshte NJQV Velipoje e cila bën pjesë në Qarkun e Shkodrës , gjendet në Jug-Perëndim të Qytetit të Shkodrës në një largësi prej rreth 24 km prej tij, në Veri-Perëndim kufizohet nga Mali i Zi përgjatë lumit Buna, në Lindje nga Qarku i Lezhës, në Veri nga Komuna e Dajçit dhe në Jug nga deti Adriatik. Sipërfaqja totale e Komunës është 72.4 km². E gjithë zona është një fushë e madhe e rrethuar nga kodrat e Baksit, Çasit, Shtiqnit dhe Maja e Zezë.

Numri i popullsisë aktuale në tërë NJQVe Velipojës është 8270 banorë një popullsi me tendencë rritjeje të shpejtë nga faktorë të ndryshëm si migrimi brenda territorit, tërheqja e vëmendjes së publikut për të investuar në turizëm etj. NJQV e Velipojës përbëhet nga 10 fshatra të cilët janë: Velipojë, Reç-Pulaj, Luarzë, Gomsiqe e Re, Baks- Rrjoll, Pulaj-Plazh, Reç i Ri, Baks i Ri, Ças, Mali Kolaj.

Pershkrimi i gjendjes aktuale te objektit

Rruga fillon në kilometrin 0 nga rruga automobilistike kombëtare Shkodër – Tiranë mbas Urës së Baçallëkut në Bërdicë dhe merr drejtimin duke kaluar paralel me lumin Buna në bregun e majtë të këtij lumi në fushën e Kolcës e cila është bonifikuar në vitet 60-70 të shekullit të kaluar. Rruga kalon pranë fshatit Trush; kalon në fushën e Dardhës deri tek Ura Gjo Lulit dhe mbas 4 km mbaron në fshatin Gomsiqe. Gryka e Gjo Lulit formohet midis Rencit dhe Gjymtit me gjerësi rreth 480 m dhe thellësi 135-150 m. Kjo grykë është me origjinë tektonike erozive. Për origjinën tektonike të kësaj gryke dëshmojnë shpatet e thikta dhe pothuajse vijëdrejt dhe vendosja e tyre në një rajon me një tektonikë shumë të fuqishme dhe në ditët tona.

Fusha e Trushit që kalon rruga në studim në bregun e majtë të lumit Buna e deri në skajin V-P të kodrave të Renc-Kakariq. Në veri-perëndim ajo kufizohet me kodrat e ulëta gëlqerore të Gjymtit.

E gjithë kjo fushë e madhe ka një reliev shumë të rrafshet, që për të

cilën ajo përmbytet gjithnjë gjatë vërshimeve të Drinit dhe Bunës. Për ta mbrojtur nga përmbytjet gjatë bregut të majtë të Bunës është ndërtuar një argjinaturë dheu. Gjithashtu është bërë bonifikimi i plotë i saj me një radhë kanalesh kullues dhe vaditës.

Segmenti rrugor Harku i Berdices - Baks, për nga rëndësia dhe intesiteti parashikohet të jetë rrugë kryesisht për trafik të tonazhit të lehte dhe të mesëm. Ajo do të ketë njëkohësisht disa funksione:

- 1 – Do i shërbejë zhvillimit urban të zonës duke qënë një nga arteriet kryesore që kalon në këtë zonë.
- 2 – Do i shërbejë rritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit në zonën turistike të Velipojës.

Gjate gjithë gjatësisë së rruges janë bërë zgjerime që të arrihen parametrat gjeometrike të kërkuar, duke bërë përmirësimet e mundshme në funksion të zonës dhe distancave të objekteve.

Elementet e janë:

Shpejtësia e projektimit sipas terrenit:

☞ Te gjithë terrenet $V_{proj}=100$ km/ore

Rrezet minimale:

☞ Te gjithë terrenet 340 m (Vproj=90 km/ore)

Tabela 3: Rrezja minimale dhe gjatësia minimale e kthesës rrethore

V_D [km/h]	min R [m]	min L [m]
50	80	30
60	120	35
70	180	40
80	250	45
90	340	50
100	450	55
120	720	65

Rrezja Minimale

Bazuar në sa më sipër që rrezja minimale e kurbave në rrugë për shpejtësi llogaritesë 90 km/ore duhet të jetë 340m.

Elementet e rruges jane si me poshte

Prog. 0 - 0.472

Trotuar nga nje ane, gjelberim, kanalizime te ujrave te zeza dhe ndricim ne zonen e banuar nga fillimi rruges deri ne progresivin 0.472km ku mbaron zona e banuar.

Prog. 0.472 - 4.410

Kemi devijim nga gjurma ekzistuese per rreth 4km. Kjo zone do te kete nje ngritje nga kuota ekzistuese e terrenit deri ne rreth 2m. Arsyeya e kesaj rritje ne kuote vjen nga dy shkaqe kryesore, tokat e buta qe nuk sherbejne si themel i qendrueshem per rrugen dhe ne kete menyre duhet te krijohet nje kasonete dhe mbushje qe te arrijme rezistencen e kerkuar, dhe mbushja e rruges do te sherbeje si nje dige ne rastet kur kemi shira dhe permbytje ne kete zone. Per kalimin e automjeteve (sidomos ato bujqesore) kemi krijuar akses midis dy hapesirave qe ndan rruga me dy nenkalime.

Ne fund te kesaj pjese kemi dhe bashkimin e rruges se projektuar me gjurmen ekzistuese.

Gjithashtu ne gjithe gjatesine e saj kemi mbrojtje te skarpatave me shtrese vegjetale dhe veshje bari. Pothuaj ne gjithe gjatesine sipas projektit kemi ne te dy anet seksionim kanali.

Prog. 4.410 - 6.312

Ne kete pjese te rruges kemi seksionim kanali dheu ne anen e majte se bashku me mbrojtje skarpate me beton. Ne anen e djathte kemi kanal betoni per mbledhjen e ujrave siperfaqesor te rruges dhe po me tej ne anen e djathte kemi kanal me beton per mbledhjen e ujrave te shiut.

Prog. 6.312 - 6.762

Ne kete pjese kemi seksionim kanali ne anen e majte. mbrojtje te skarpatave me beton dhe me gjeocell. Ne anen e djathte kemi seksionim kanali dheu. Ne fillim te kesaj pjese kemi ure Hd 1x10m.

Prog. 6.762 - 7.300

Ketu hyjme ne zone te banuar dhe do te kemi trotuar, kanalizime te ujrave te shiut, gjelberim dhe ndricim nga ana e majte. Nga ana e djathte e rruges do te kemi seksionim kanal dheu.

Prog. 7.300 - 9.096

Ne kete pjese te rruges dalim serish nga zona e banuar dhe do te kemi ne anen e majte dhe te djathte te rruges seksionim kanale dheu, dhe mbrojtje te skarpatave me gjeocell dhe veshje betoni.

Prog. 9.069 - 13.807

Ne kete pjese te rruges kemi dy kanale te medhaja kullues ne te dyja anet e rruges. Jane mbrojtur te dy anet e skarpates me gjeocell dhe eshte veshur skarpata e cila ka ngjitur kanalin kullues me beton.

Ne kete pjese te rruges gjenden 3 ura, nje ure me Hd 10m, nje ure me Hd 15m dhe Ura e Gjo Lulit me Hd 4x15m.

Prog 13.902 - 14.303 dhe 14.470 - 15.605

Keto pjese te rruges jane hyrje dhe dalje ne lugine dhe do te trajtohet njera prej skarpatave me gjeocell.

Prog. 14.303 - 14.470 dhe 15.605 - 16.005

Ne kete pjese te rruges do te kemi germime ne masive shkembore. Gjurma e rruges ketu devijon nga gjurma e rruges ekzistuese per te arritur rrezet minimale te ktheses per rruge te kesaj kategorie. Do te kemi skarpata te thepisura me tarrace ne cdo 7m lartesi. Materiali i germuar ne kete pjese rruge do te perdoret per mbushje.

Prog. 16.005 - 17.123

Rruga ne kete pjese ndjek pergjithsisht gjurmen ekzistuese dhe do te kemi vetem seksionim kanalesh dheu ne te dy anet e rruges.

Prog. 17.123 - 17.912

Dhe kjo pjese korenspondon me germime ne masive shkembore sic eshte dhe pjesa e prog. 14.303-14.470 dhe 15.605-16.005.

Kemi devijim nga gjurma ekzistuese per shkak te arritjes se rrezes minimale te kthimit. Ne anen e djathte do te ndertohen mure mbajtes 3-4m.

Prog. 17.912 - 18. 311

Ne kete pjese fundore te rruges kemi zonen e banuar te Baksit dhe do te trajtohet me trotuare, gjelberim, ndricim dhe kanalizime te ujrave te zeza ne anen e djathte te rruges.

Pergjate gjithe rruges, ne pjeset e nevojshme te saj parashikohen guardrail. Per mbrojtjen nga ujrat nentokesore parashikohet mbrojtje me gjeotekstil. Tombinat ekzistuese ku kalon gjurma e re e rruges jane rillogaritur dhe jane projektuar te reja, po ashtu jane parashikuar tombino me dimensionet nga 2x2m deri ne 5x6m dhe ne segmentin ku gjurma e rruges eshte teresisht e re.

Jane parashikuar mure mbajtes e prites ne zonat qe eshte e nevojshme.

Ne pjeset e rruges ku trupi i rruges i mbivendoset nje kanal kullues ekzistues eshte ndertuar nje kasonete dhe mbushje ne trupin e kanalit ekzistues.

Sistemi i Ndricimit Rrugor.

Gjithashtu ne te tere gjatesine e rruges te percaktuar ne planimetri si zone urbane do te ndertohet sistemi i ndricimit rrugor. Ai do ndertohet ne dy krahet ne te gjithe gjatesine e rruges. Ai do ndertohet me shtylla metalike me $H=8.8m$ dhe me spesor $\delta=4m$.

URA 4x15m (Ura e Gjo Lulit)

Ne kete projekt parashikohet ndertimi i nje ure beton arme qe lidh dy brigjet e lumit Velipoje. Percaktimi i pozicionit per vendosjen e ures, eshte bere ne perputhje me studimin hidrologjik si dhe ate gjologo-inxhinierik. Ura do te kete nje pozicion planimetrik, 90° , me shtratin e lumit Velipoje. Mbistruktura eshte e vendosur

horizontalisht duke bere rakordimet perkatese me projektin e rruges. Gjeresia totale e ures eshte 12.5 m, me dy kalime me gjeresi 4.75 m secila. Ura do te kete nje gjatesi prej 4 x 15.0 m si dhe dy trotuar nga 1.5 m secili. Pasqyra e lire ujore eshte 2.0 m duke iu referuar nivelit maksimal te ujrave te ketij lumi.

Nenstruktura e ures eshte realizuar me ane te jastekeve me pilota beton arme, nisur edhe nga rekomandimet gjeologo-inxhinierike. Pilotat beton arme jane me diameter Ø100 cm dhe gjatesi 14.0 m dhe 16.0 m. Materiali i pilotave eshte beton i klasit C25/30 (M-300). Pilotat zhyten deri ne shtresen zhavorrore Nr.6 e cila sipas relacionit gjeologjik eshte e pershtatshme per te suportuar ngarkesat qe vijen ne themel.

Mbeshtetjet anesore te ures jane realizuar me anen e ballnave beton arme. Trashesia e murit vertikal te ballnave eshte 100 cm. Nga pas shpatullave jane vendosur soletat rakorduese me trashesi 25cm dhe permasa 4.0 m x 3.5 m ne plan. Per te mbrojtur skarpaten e mbushjes nga pas ballnave, keto te fundit zgjatohen ne formen e mureve beton arme. Ballnat jane realizuar me beton te klasit C25/30 (M-300). Mbeshtetjet e mesit jane te realizuar me ane te muri vertikal me trashesi 120 cm. Pilat beton arme ne pjesen e sipërme te tyre bashkohen me nje tra (jastek) beton arme i cili ka nje gjeresi 190 cm dhe lartesi qe varion nga 160 cm ne mbeshtetje deri ne 80 cm ne maje.

SHPRONESIME DHE PRISHJE

Per kete projekt zbatim shpronesohen 142.842 m² toke.

Siperfaqe prishje objekte: 522 m²

Volum prishje (mure, tombino, vepra te tjera arti): 2305

Tirane 2017